

---

Propozimi i të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale dhe Nordike për hipotezat dhe një metodologji të Analizës së Kosto-Përfitimit në përputhje me Nenin 156 (11) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike

---

Datë: 2 Mars 2018

## Përmbajtja

Neni 1. Objekti i lëndës dhe fushëveprimi .....	4
Neni 2. Përkufizimet dhe interpretimi.....	4
Neni 3. Rezultatet dhe proceset e metodologjisë së CBA .....	5
Neni 4. Modeli Propabilistik i Simulimit.....	5
Neni 5. Vlerësimi i kostos së FCR .....	7
Neni 6. Skenarët e simulimit.....	7
Neni 7. Simulimi i ngjarjeve më të rëndësishme të frekuences reale në prezencën e LER ....	8
Neni 9. Përcaktimi dhe përditësimi i Periudhës Kohore .....	8
Neni 10. Hipotezat e Analizës së Kosto Përfitimit .....	8
Neni 11. Shtojca.....	9
Neni 12. Publikimi dhe zbatimi i metodologjisë së CBA-së për Propozimin e FCR-së.....	9
Neni 13. Gjuha .....	9

Të gjitha OST-të e Evropës Kontinentale dhe vendeve Nordike, duke marrë parasysh si më poshtë që:

1. Ky dokument është një propozim i përbashkët i hartuar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit të Evropës Kontinentale dhe zonave sinkrone Nordike (këtej e tutje referuar si "OST-të") në lidhje me përcaktimin e hipotezave dhe një metodologjie për një Analizë të Kosto-Përfitimit (këtej e tutje referuar si "CBA") që do të kryhet, me qëllim që të vlerësohet periudha kohore e kërkuar për rezervat e mbajtjes së frekuencës (këtej e tutje referuar si "FCR") njësitë ose grupet ofruese (këtej e tutje referuar si "ofruesit e FCR-së") me Rezervuarë të Kufizuar të Energjisë për të mbetur të disponueshem gjatë gjendjes së alarmit, në përputhje me nenin 156 (11) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (këtej e tutje referuar si "Rregullorja e Udhëzuesit për Operimin e Sistemit"). Këtij propozimi këtej e tutje i referohemi si "Metodologjia e CBA-së për Propozimin e FCR".
2. Metodologjia e CBA-së për Propozimin e FCR merr në konsideratë parimet dhe qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në Rregulloren e Udhëzimit për Operimin e Sistemit si dhe Rregulloren (EC) Nr 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 mbi kushtet e aksesit në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike (këtej e tutje referuar si "Rregullorja KE, Nr 714/2009"). Qëllimi i Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit është ruajtja e sigurisë operacionale, cilësisë së frekuencës dhe përdorimi efikas i sistemit dhe burimeve të ndërlidhura. Ai përcakton për këtë qëllim kërkesat për ofruesit e FCR-së, duke siguruar që njësitë ose grupet ofruese të tyre të FCR-së me Rezervuarë të Kufizuar të Energjisë të jenë në gjendje të aktivizojnë plotësisht FCR-në në mënyrë të vazhdueshme në gjendje alarmi, për një periudhë kohore minimale që do të përcaktohet në përputhje me Nenin 156 (10) dhe (11) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit.
3. Neni 156 (9) i Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit parashikon që, në rast se nuk është përcaktuar asnjë afat kohor në pajtim me Nenin 156 (10) dhe (11) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit, secili ofrues i FCR duhet të sigurojë që njësitë ose grupet

e tij ofruese të FCR me Rezervuarë të Kufizuar të Energjisë janë në gjendje të aktivizojnë plotësisht FCR në mënyrë të vazhdueshme së paku për 15 minuta ose, në rast të devijimeve të frekuencës që janë më të vogla se një devijim i frekuencës që kërkon aktivizimin e plotë të FCR-së, për një periudhë kohe të barabartë ose për një periudhë të përcaktuar nga secili OST, e cila nuk duhet të jetë më e madhe se 30 min ose më e vogël se 15 minuta. Për më tepër, parashikohet që, nëse është përcaktuar një periudhë kohe në pajtim me Nenin 156 (10) dhe (11) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit, secili ofrues i FCR-së duhet të sigurojë që njësitë ose grupet ofruese të FCR-së së tij me Rezervuarë të Kufizuar të Energjisë duhet të jenë në gjendje të aktivizojnë plotësisht FCR në mënyrë të vazhdueshme në gjendjen e alarmit për atë periudhë kohe të vlerësuar.

4. Neni 156 (10) i Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit kërkon që të gjithë OST-të e Evropës Kontinentale dhe Nordike të hartojnë një propozim në lidhje me periudhën minimale të aktivizimit që duhet të sigurohet nga ofruesit e FCR-së dhe specifikon që periudha e përcaktuar nuk duhet të jetë më e madhe se 30 min ose më e vogël se 15 minuta. Propozimi i tillë duhet të marrë parasysh plotësisht rezultatet e CBA-së së kryer në pajtim me Nenin 156 (11) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit.
5. CBA do të marrë parasysh së paku:
  - a) përvojat e mbledhura me afatet kohore dhe pjesëmarrjes së teknologjive në zhvillim në blloqe të ndryshme të LFC;
  - b) ndikimin e një periudhe kohore të përcaktuar në koston totale të rezervave të FCR në zonën sinkrone;
  - c) ndikimin e një periudhe kohore të përcaktuar në rrezikimin e qëndrueshmërisë së sistemit, në veçanti gjatë ngjarjeve të zgjatura ose të përsëritura të frekuencës;
  - d) ndikimin mbi rrezikimin e sigurisë së sistemit dhe koston totale të FCR-së në rast të rritjes së volumit total të FCR-së;
  - e) ndikimin e zhvillimeve teknologjike në kostot e periudhave të disponueshmërisë për FCR-në nga njësitë ose grupet ofruese të FCR-së së tij me Rezervuarë të Kufizuar të Energjisë.
6. Kjo metodologji e CBA-së për Propozimin e FCR është e lidhur ekskluzivisht me njësitë ose grupet ofruese të FCR-së me Rezervuarë të Kufizuar të Energjisë.

Sipas nenit 6 (6) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit, duhet përshkruar ndikimi i pritshëm i metodologjisë së CBA-së për Propozimin e FCR mbi objektivat e Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit (siç është e listuar në Nenin 4 (1) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit). Metodologjia e propozuar e CBA-së për Propozimin e FCR në përgjithësi kontribuon në arritjen e objektivave të Nenit 4 (1) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit. Në mënyrë të veçantë, metodologjia e CBA-së për Propozimin e FCR iu siguron OST-ve të zonave sinkrone të Evropës Kontinentale dhe Nordike një metodologji për të vlerësuar dhe hartuar një propozim në lidhje me periudhën minimale të aktivizimit që duhet të sigurohet nga ofruesit e FCR. Përcaktimi i një periudhe kohore minimale të aktivizimit që duhet të sigurohet nga ofruesit e FCR gjatë gjendjes së alarmit, kontribuon në përcaktimin e kërkesave dhe parimeve të përbashkëta të sigurisë operationale, të përcaktuara në nenin 4 (1) (a) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit. Për më tepër, ai kontribuon në sigurimin e kushteve për ruajtjen e sigurisë operationale në të gjithë Unionin siç parashikohet në nenin 4 (1) (d) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit. Së fundmi ai kontribuon në operimin efikas dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe të sektorit të energjisë elektrike në Union, siç është përcaktuar në nenin 4 (1) (h) të Rregullores së

Udhëzuesit për Operimin e Sistemit. Metodologjia e CBA-së për Propozimin e FCR nuk ndikon në objektivat e tjerë të listuara në Nenin 4 (1) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit.

7. Në përfundim, metodologjia CBA-së për Propozimin e FCR kontribuon në ndjekjen e objektivave të përgjithshme të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit për ruajtjen e sigurisë operacionale duke përcaktuar periudhën e duhur kohore për aktivizimin e plotë të FCR në gjendjen e alarmit duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet e periudhës kohore të përcaktuar, në të mirën e të gjithë pjesëmarrësve të tregut dhe konsumatorëve fundorë të energjisë elektrike.

## PARAQESIN METODOLOGJINË E MËPOSHTME TË CBA-së PËR PROPOZIMIN E FCR TË GJITHA AUTORITETEVE RREGULLATORE TË ZONËS SË EVROPES KONTINENTALE DHE NORDIKE:

### Neni 1. Objekti i lëndës dhe fushëveprimi

Hipotezat dhe metodologjia e CBA-së siç përcaktohet në këtë metodologji të CBA-së për Propozimin e FCR do të konsiderohet si propozimi i përbashkët i të gjithë OST-ve të Evropës Kontinentale dhe Nordike në përputhje me nenin 156 (11) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit dhe do të përbëjë bazën mbi të cilën OST-të e zonave sinkrone të Evropës Kontinentale dhe Nordike duhet të vlerësojnë periudhën kohore minimale të aktivizimit që duhet të sigurohet nga ofruesit e FCR-së në përputhje me Nenin 156 (10) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit.

### Neni 2. Përkufizimet dhe interpretimi

1. Për qëllime të metodologjisë së CBA-së për Propozimin e FCR-së, termat e përdorur në këtë dokument kanë kuptimin e përkufizimeve të përfshira në nenin 3 të Rregullores së Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit, Rregullores të (KE) 714/2009, Direktivës 2009/72 / KE dhe Rregullores (BE) 543/2013.
2. Përveç kësaj, në këtë metodologji të CBA-së për Propozimin e FCR, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimin si vijon:
  - a) "LER" nënkupton "njësitë ose grupet gjeneruese të FCR-së me Rezervuarë të Kufizuar të Energjisë";
  - b) "LER Share" nënkupton "pjesën e LER në ofruesit totalë të FCR-së";
  - c) "Disbalancat e nxitura nga tregu" nënkuptojnë "disbalanca gjenerim-ngarkesë e shkaktuar nga ndryshimi në tarimet e gjenerimit në përputhje me rezultatet e skedulimit të tregut".
  - d) "Pjerrësia i sistemit" (system droop) nënkupton "raportin midis devijimit të frekuencës dhe përgjigjes së fuqisë së gjendjes së qëndrueshme, të siguruar nga FCP";
  - e) "Kurba e kostos së FCR" nënkupton "grupin e të gjithë sasive të ofruara të FCR me kostot e tyre respektive";
  - f) "Periudha kohore", në përputhje me Nenin 156 (9) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit, nënkupton "koha për të cilën secili ofrues i FCR duhet të sigurojë që njësitë ose grupet e tij sigurojnë me Rezervuarë të Kufizuar të Energjisë të FCR-

së, janë në gjendje të aktivizojnë plotësisht FCR-në në mënyrë të vazhdueshme, sapo nxitet gjendja e alarmit dhe gjatë gjendjes së alarmit”;

- g) “Devijimi i qëndrueshëm i frekuencës” nënkupton një “ngjarje me një devijim të qëndrueshëm mesatar të frekuencës më të madh se sa diapazoni standard i frekuencës, kundrejt një periudhe më të gjatë se sa koha për rivendosjen e frekuencës”.
- h) “FAT” do të thotë “Koha e aktivizimit të FRR-së plotësisht” siç përcaktohet në nenin 3 (101) dhe (143) të Rregullores së Udhëzuesit për Operimin e Sistemit. “Kapaciteti ekuivalent i rezervuarit të energjisë” nënkupton kërkesën për energji për LER-ët lidhur me Periudhën Kohore dhe do të konsiderohet sa dyfishi i energjisë së siguruar nga aktivizimi i plotë i LER për Periudhën Kohore.

3. Në këtë metodologji të CBA-së për Propozimin e FCR-së, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe:

- a) njëjësi tregon shumësin dhe anasjelltas;
- b) përveç nëse nuk parashikohet ndryshe, çdo referencë në një Nen nënkupton një Nen të kësaj metodologjie të CBA-së për Propozimin e FCR-së;
- c) tabela e përmbajtjes dhe titujt janë vendosur vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj metodologjie të CBA-së për Propozimin e FCR-së; dhe
- d) çdo referencë në legjislacion, rregullore, direktivë, urdhër, instrument, kod ose ndonjë akt tjetër do të përfshijë çdo modifikim, shtesë ose ri-miratim të tij dhe më pas hyn në fuqi.

### Neni 3. Rezultatet dhe proceset e metodologjisë së CBA

Për çdo kombinim të LER Share dhe Periudhës Kohore (siç përshkruhet në Nenin 6 (2) (a) dhe Nenin 6 (2) (b)), rezultatet e metodologjisë së CBA-së janë:

- a) kosto e FCR-së (siç përshkruhet në Nenin 4 dhe Nenin 5);
- b) pranimi i kombinimit kundrejt ngjarjeve reale më të rëndësishme të frekuencës (siç përshkruhet në Nenin 7).

Kostoja e FCR-së llogaritet me anë të dy proceseve vijuese.

Procesi i parë është një Model Probabilistik Simulimi (i përshkruar në Nenin 4), rezultati i të cilit është sasia e FCR-së.

Procesi i dytë është një Vlerësim i koston të FCR-së (i përshkruar në Nenin 5) i cili lidh një kosto me sasinë e kërkuar të FCR-së ë llogaritur nga Modeli Probabilistik i Simulimit.

Pranimi i kombinimit kundrejt ngjarjeve reale më të rëndësishme të frekuencës vlerësohet me anë të një procesi të dedikuar (i përshkruar në Nenin 7).

### Neni 4. Modeli Probabilistik i Simulimit

1. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone do të hartojnë një Model Probabilistik Simulimi i cili të jetë në gjendje të llogarisë sasinë minimale të FCR-së së nevojshme për të ruajtur frekuencën në gjendje të qëndrueshme brenda devijimit maksimal të frekuencës në gjendje të qëndrueshme.
2. Burimet e mëposhtme të shqetësimeve të frekuencës janë informacion hyrës i Modelit Probabilistik të Simulimit:

a. Devijimi deterministik i frekuencës

OST-të do të marrin në konsideratë disbalancat e nxitura nga tregu, do të analizojnë trendin historik të frekuencës të secilës zonë sinkrone gjatë disa viteve dhe pastaj do të përcaktojnë statistikisht tendencat dhe amplitudat tipike të këtyre devijimeve të frekuencës, në mënyrë që ato të përdoren si informacion hyrës në Modelin Probabilistik Simulues.

b. Devijimi i qëndrueshëm i frekuencës.

OST-të do të marrin në konsideratë parasysh devijimet e qëndrueshme të frekuencës.

Ata do të analizojnë trendin historik të frekuencës në mënyrë që të karakterizojnë fenomenin nga pikëpamja statistikore. Analiza do të përcaktojë:

- numrin e ndodhjes së këtyre ngjarjeve;
- kohëzgjatjen tipike;
- trendin e devijimit përfaqësues të frekuencës
- koha tipike e ndodhjes, nëse nxirret në pah nga analiza statistikore.

c. Ndërprerjet e elementeve të rëndësishëm të rrjetit.

OST-të do të përcaktojnë një listë të të gjithë elementëve të rrjetit, ndërprerjet e të cilëve çojnë në humbje të rëndësishme të ngarkesës ose gjenerimit dhe praktikisht në aktivizimin përkatës të FCR-së.

Ndërprerjet e elementëve të rrjetit që do të shqyrtohen janë së paku: avaritë në centralet gjeneruese, difektet në zbarat kritike dhe çkycjet e nënstacionit të rëndësishëm. Për çdo ndërprerje duhet të përcaktohet probabiliteti i humbjes.

I gjithë informacioni në dispozicion në lidhje me ndërvarësinë midis tre burimeve të shqetësimeve të frekuencës të listuara më sipër do të merret parasysh në mënyrë që të shmanget numërimi i dyfishtë i fenomenit.

3. Modeli Probabilistik i Simulimit do të përdoret për të llogaritur FCR e kërkuar për secilin skenar të përshkruar në Nenin 6. Prandaj, për modelin edhe variablat e mëposhtëm paraqesin informacion hyrës:

- a. Periudha Kohore;
- b. LER Share;

Për më tepër, edhe mesatarja e FAT e zonës sinkrone është një parametër hyrës për Modelin Probabilistik të Simulimit.

4. Modeli probabilistik simulues llogarit FCR-në e kërkuar duke përdorur metodën iterative. Në çdo përsëritje, Modeli Probabilistik i Simulimit përdor një Proçes Simulimi të Monte Carlo-s në mënyrë që të verifikojë nëse frekuenca e gjendjes së qëndrueshme është brenda devijimit maksimal të frekuencës së gjendjes së qëndrueshme. Nëse kushti nuk është plotësuar, Modeli Probabilistik i Simulimit rrit gradualisht FCR-në dhe llogarit përsëritjen e radhës. Iteracionet ndalojnë sapo të plotësohet kushti. Përfundimi i nxjerrë nga Modeli Probabilistik i Simulimit është FCR-ja e duhur për të ruajtur frekuencën e gjendjes së qëndrueshme brenda devijimit maksimal të frekuencës së gjendjes së qëndrueshme.

5. Proçesi i simulimit të Monte Karlos duhet të jetë në gjendje të simulojë disa vite të kushteve të operimit të secilës zonë sinkrone me anë të tërheqjeve të rastësishme të devijimeve të qëndrueshme të frekuencës dhe ndërprerjeve të elementeve të rëndësishëm të rrjetit. Ai ka për qëllim të gjenerojë një numër të madh të kombinimeve të rastësishme të të gjitha

burimeve të mundshme të luhatjeve të frekuencës. Meqenëse procesi i simulimit i Monte Carlo punon në fushën e kohës, kjo metodë kërkon simulimin e një periudhe të gjatë të operimit të sistemit. Periudha e operimit që do të simulohet duhet të jetë e gjatë mjaftueshëm sa për të gjeneruar rezultate statistiki të rëndësishme.

6. Procesi i simulimit i Monte Carlo-s përdor një model dinamik simulimi për të llogaritur devijimin e frekuencës. Modeli i simulimit dinamik përdor si informacion hyrës burimet e shqetësimeve të frekuencës, të gjeneruara rastësisht nga procesi i Simulimit i Monte Carlo-s dhe simulon FCP-në dhe FRP-në.
7. Modeli Dinamik i Simulimit do të jetë në gjendje të simulojë shterimin e LER dhe efektet e tij në devijimin e frekuencës, duke marrë parasysh LER Share dhe Periudhën Kohore.

#### Neni 5. Vlerësimi i kostos së FCR

1. Sasia minimale e FCR-së së nevojshme për të ruajtur gjendjen e qëndrueshme të frekuencës brenda devijimit maksimal të frekuencës në gjendje në qëndrueshme të llogaritur nga Modeli Probabilistik Simulues, do të përdoret për të vlerësuar koston e FCR-së lidhur me secilin skenar me anë të një kurbe të koston së FCR-së.
2. Të gjitha OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë kurbën e koston së FCR-së, e cila përfshin ofruesit e LER dhe Jo-LER të FCR-së.
3. Kostoja e FCR-së për ofruesit Jo-LER të FCR-së do të llogaritet të paktën duke krahasuar koston marxhinale të ofruesit të FCR-së me çmimin marxhinal të energjisë së zonës ofertuese. Krahasimi lejon të vlerësohet kostoja e kapacitetit rezervë për sigurimin e FCR-së.
4. Kostoja e FCR-së për LER-ët e ardhshëm të instaluar do të llogaritet duke marrë në konsideratë: investimet, OPEX dhe koston oportune (nëse ka). Këto kontribute duhet të merren parasysh vetëm nëse janë të qëndrueshme në mënyrë që të kualifikohen për ofrimin e FCR.
5. Koston e FCR-së për LER-ët tashmë ekzistuese do të llogariten duke marrë në konsideratë: OPEX dhe koston oportune (nëse ka). Këto kontribute do të konsiderohen vetëm nëse ato janë të qëndrueshme me qëllim që të klasifikohen për sigurimin e FCR.
6. Ndikimi mbi koston e FCR-së për LER-ët duhet të merret në konsideratë për shkak të kërkesave të ndryshueshme të rezervuarëve të energjisë (të lidhura me Periudhën Kohore).

#### Neni 6. Skenarët e simulimit

1. Analizat dhe proceset e përshkruara në nenin 4 dhe 5 duhet të realizohen duke marrë në konsideratë skenarët të ndryshëm dhe që lejojnë të llogaritet dimensionimi i FCR-së dhe kosto e FCR-së duke marrë parasysh supozime të ndryshme. Skenarët kanë si qëllim të adresojnë pasiguritë dhe të vlerësojnë impaktin e hipotezave të ndryshme të cilat mund të ndikojnë rezultatet e Analizës së Kosto-Përfitimit.
2. Grupi i skenarëve duhet të përfshijë të gjitha kombinimet e supozimeve në vijim:
  - a. Periudha kohore. Në mënyrë që të vlerësohet zgjidhja më e mirë në termat të periudhës minimale të aktivizimit, e cila nuk është më e madhe se 30 min. ose më e vogël se 15 min., intervali i zgjidhjeve të mundshme duhet të hulumtohet duke miratuar një përafrim të mundshëm. Kur zbatohet metodologjia e CBA-së për Propozimin e FCR, OST-të duhet të konsiderojnë një përafrim prej 5 minutash, kështu që duhet të vlerësohen rezultatet duke konsideruar periudhën kohore prej 15,20,25 dhe 30 minutash.

- b. LER Share. Pjesa që ndahet e LER-ve mund të ndikohet nga efikasiteti i koston së LER, por gjithashtu edhe nga faktorë të tjerë, si prezenca e prokurimit të FCR-së me bazë tregu ose impaktet e tjera teknike dhe rregullatore të shkarkimit të LER. Për këtë arsye, do të analizohen LER Share të ndryshme në diapazonin 10-100% me 10% përafrim.
3. Të gjitha analizat do të kryhen duke marrë parasysh zhvillimet e mundshme të ardhshme të sistemit energjetik dhe rregulloret në terma afat- shkurtër.
4. Përpunimi i rezultateve të përfituara nga kryerja e analizave të përshkruara në nenet 4 dhe 5 në tërësinë e skenarëve duhet të lejojë, përfitimin e dimensionimit të FCR-së dhe kostot e FCR-së për çdo kombinim mes Periudhës Kohore dhe LER Share.

#### Neni 7. Simulimi i ngjarjeve më të rëndësishme të frekuencës reale në prezencën e LER

1. Çrregullimet më të rëndësishme të frekuencës të ndodhura në të kaluarën do të simulohen duke modeluar praninë e LER-vë dhe duke vlerësuar se si shterimi i energjisë potenciale do të kishte ndikuar në qëndrueshmërinë e sistemit.
2. Simulimi i ngjarjeve reale më të rëndësishme të frekuencës, do të kryhet për çdo kombinim të Periudhës Kohore dhe LER Share në përcaktuar Nenin 6 (2a) dhe (2b). Nëse një kombinim i Periudhës Kohore dhe LER Share përkeqëson potencialisht sigurinë operationale duke çuar në gjendje black-out, kombinimi do të konsiderohet i papranueshëm.

#### Neni 9. Përcaktimi dhe përditësimi i Periudhës Kohore

Sipas Nenit 156 (11), 12 muaj pas miratimit të supozimeve dhe metodologjisë së paraqitur këtu nga të gjitha autoritetet rregullatore të rajonit respektiv, OST-të e Evropës Kontinentale dhe zonave sinkrone Nordike duhet të dorëzojnë në autoritetet rregullatore përkatëse, rezultatet e analizës së tyre të kosto-përfitimit, duke sugjeruar një Periudhë Kohore që nuk duhet të jetë më e madhe së 30 minuta ose më e vogël së 15 minuta.

Në çdo rast, pas çdo ndryshimi të rëndësishëm të supozimeve për analizën e kosto-përfitimit, pas hyrjes në fuqi të Periudhës Kohore, të gjitha OST-të e Evropës Kontinentale dhe zonave sinkrone nordike duhet të paraqesin rezultatet e një analize të kosto-përfitim të përditësuar tek autoritetet përkatëse rregullatore, duke sugjeruar një Periudhë Kohore të përditësuar e cila nuk duhet të jetë më e madhe së 30 minuta ose më e vogël së 15 minuta.

#### Neni 10. Hipotezat e Analizës së Kosto-Përfitimit

1. Modeli Probabilistik i Simulimit i përshkruar në Nenin 4 (1) (2) (3) (4), procesi i Simulimit i Monte Karlo-s i përshkruar në Nenin 4 (1) (5) (6) dhe Modelin Dinamik Simulues të përshkruar në Nenin 4 (7) duhet t'i referohet një zone të tërë sinkrone.
2. Modeli Dinamik Simulues do të simulojë FRP-në me një kontrollues të vetëm të FRP-së pa kufizime të FRR-së.
3. Modeli Dinamik Simulues mund të neglizhojë të gjithë procesin Ndërkufitar të Kontrollit Ngarkesë-Frekuencë.
4. Modeli Dinamik Simulues mund të neglizhojë inercinë e sistemit dhe dinamikën e vendosjes së FCP-së.

5. Modeli Dinamik Simulues do të simulojë së paku dinamikën e vendosjes së FRP, pjerrësinë e sistemit(system droop) dhe vetë-rregullimin e ngarkesës.
6. Nëse tejkalimi i vazhdueshëm i diapazonit të frekuencës standarte çon në nxitjen e një gjendje alarmi, energjia e aktivizuar dhe energjia e mbetur në rezervuar llogaritet nga tejkalimi i parë i kufijve standarte të frekuencës.
7. Në disponueshmërinë e plotë të rezervuarit, niveli i energjisë do të konsiderohet i barabartë me gjysmën e kapacitetit të energjisë së rezervuarit Ekuivalent.

#### Neni 11. Shtojca

Dokumenti i shtojcës ka për qëllim t'u ofrojë palëve të interesuara informacionin, shpjegimin dhe hollësitë e mëtejshme mbi kërkesat e specifikuar në metodologjinë e CBA-së për Propozimin e FCR-së dhe duhet të lexohet së bashku me metodologjinë CBA-së për Propozimin e FCR-së.

#### Neni 12. Publikimi dhe zbatimi i metodologjisë së CBA-së për Propozimin e FCR-së

1. Pasi të gjitha ERE-të e kanë miratuar metodologjinë e propozuar të CBA-së për Propozimin e FCR, në përputhje me nenin 8 të Rregullores së Udhëzimit për Operimin e Sistemit, çdo OST e Evropës Kontinentale dhe Nordike do të publikojnë metodologjinë e CBA-së për Propozimin e FCR-së pa vonesa të panevojshme.
2. OST-të e Evropës Kontinentale dhe Nordike duhet të zbatojnë metodologjinë e miratuar të CBA-së për Propozimin e FCR-së, 12 muaj pas miratimit të saj nga të gjitha autoritetet rregullatore të zonave sinkrone të Evropës Kontinentale dhe zonave Nordike. Zbatimi do të bëhet duke paraqitur rezultatet e CBA-së së kryer nga OST-të e zonave sinkrone të Evropës Kontinentale dhe Nordike sipas metodologjisë së miratuar CBA-së për Propozimin e FCR tek autoritetet përkatëse rregullatore dhe duke sugjeruar një periudhë kohore për ofruesit e FCR me Rezervuarë të Kufizuar të Energjisë gjatë së cilës ata duhet të jenë në gjendje të aktivizojnë plotësisht FCR në vazhdimësi në gjendje alarmi , ku kjo periudhë kohore nuk duhet të jetë më e madhe së 30 min ose më e vogël së 15 minuta.

#### Neni 13. Gjuha

Gjuha referente për këtë metodologji të CBA-së mbi Propozimin e FCR duhet të jetë Anglisht. Për shmangien e dyshimit, atje ku OST-të duhet të përkthejnë këtë metodologji të CBA-së për Propozimin e FCR-së në gjuhën(t) e tyre kombëtare, në rast të mospërputhjeve mes versionit në gjuhën angleze të botuar nga OST-të në pajtim me Nenin 8 (1) të Rregullores së Udhëzimit për Operimin e Sistemit dhe çdo versioni në një gjuhë tjetër, OST-të përkatëse në përputhje me legjislacionin kombëtar duhet t'i ofrojë autoriteteve përkatëse kombëtare rregullatore një përkthim të përditësuar të metodologjisë së CBA-së për Propozimin e FCR-së.